



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr. 1496 prot.

Shkodër, me datë 02/02/2016

Lënda: Kërkesë për marrjen e Aktit të Përputhshmërisë për PPV-në, Bashkia Shkodër

Drejtuar: Znj. Adelina Greca,
Drejtoare e Përgjithshme
Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Për dijeni: Znj. Eglantina Gjermeni,
Ministër
Ministria e Zhvillimit Urban

E nderuar znj. Greca!

Së pari, dëshirojmë të shprehim vlerësimet më të mira për asistencën e dhënë nga stafi juaj për punën e deritanishme për hartimin e PPV të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka përfunduar dokumentin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ, sipas përcaktimeve të Ligjit 115/2014, datë 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrativo - Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" si dhe në zbatim të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në mbështetje të nenit 9 (Përgjegjësitë e Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit) neni 23 (bashkërendimi, këshillimi dhe shqyrtimi publik i dokumentave të planifikimit) si dhe në mbështetje të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" neni 59, germa a dhe b, ju lutemi të shpreheni për Konformitetin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër.

Materialet

- Analiza
- Strategjia Territoriale Shkodër
- Plani i Zhvillimit të Territorit, Bashkia Shkodër
- Rregullore e Planit
- Vlerësimi Strategjik Mjedor
- Materialet Hartografike

I gjithë materiali i mësipërm është botuar në RIT dhe mbetemi të angazhuar gjatë të gjithë procesit të miratimit të PPV-së së territorit të Bashkisë Shkodër.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,



KRYETAR


Voltana ADEMI